

UDHËZIM
Nr.1339, datë 19.11.2008

**PËR NJOHJEN DHE EKUIVALENTIMIN E TRAJNIMEVE TË KRYERA JASHTË
SHTETIT NGA PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të paragrafit 2 të nenit 7 e të paragrafit 1 të nenit 51 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”,

UDHËZOJ:

1. Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave, certifikatave dhe dëshmime, të fituara nga programet e trajnimit jashtë shtetit nga punonjësit e policisë, është:

a) E drejtpërdrejtë: Në të gjitha rastet kur njohja dhe ekuivalentimi i trajnimit, programit, diplomës, certifikatës apo dëshmisë janë vendosur me emërtim të drejtpërdrejtë në marrëveshjet dypalëshe të Ministrit të Brendshëm apo Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë me shtetin apo institucionin që ofron trajnimin.

b) E ekuivalentuar: Në të gjitha rastet kur njohja dhe ekuivalentimi nuk është përfshirë në emërtim në marrëveshjet dypalëshe, por trajnimet, programet, diplomat, certifikatat apo dëshmitë e dhëna jashtë shtetit në përfitim të punonjësve të policisë, vlerësohen dhe njihen si të njëjta me sistemin e trajnimit tonë policor dhe nuk kanë nevojë për plotësim programesh apo modulesh.

c) Me plotësim diferencash: Për të verifikuar dhe krahasuar programet e ndjekura jashtë shtetit me ato të policisë shqiptare. Në këto raste, ekuivalentimi arrihet nëpërmjet plotësimit të diferencave, të cilat realizohen në përputhje me programet e trajnimit të policisë shqiptare.

2. Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave, certifikatave dhe dëshmime të fituara nga programet e trajnimit jashtë shtetit nga punonjësit e Policisë së Shtetit, bëhet nga Komisioni i Posaçëm për Ekuivalentimin e Trajnimeve të Kryera Jashtë Shtetit nga Punonjësit e Policisë (KPE), i cili ngrihet dhe funksionon pranë Departamentit për Trajnimin Policor (DTP).

3. Komisioni i Posaçëm për Ekuivalentimin e Trajnimeve të Kryera Jashtë Shtetit nga Punonjësit e Policisë përbëhet nga:

- a) Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë në Departamentin për Trajnimin Policor
- b) Drejtorët e drejtorive përkatëse në DTP
- c) Ekspert i kurrikulave

Kryetar
Anëtarë
Anëtar, sekretar
technik i KPE

- d) Ekspert i planifikimit të trajnimeve

Anëtar

- e) Një përfaqësues i departamentit, i cili ka përfutur trajnimin

Anëtar.

4. KPE mbledhet me urdhër të zëvendës drejtorit të përgjithshëm të policisë në Departamentin për Trajnimin Policor jo më larg se 25 ditë-punë nga dita që janë regjistruar dokumentet e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij udhëzimi. Mbledhja e KPE-së bëhet vetëm nëse janë të pranishëm kryetari dhe jo më pak se 3 prej anëtarëve të KPE-së. Vendimi i KPE-së konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse është nënshkruar nga kryetari i KPE-së, mbi bazën e aprovimit nga të paktën tre prej anëtarëve.

4.1 KPE-ja i kthen përgjigje të interesuarit jo më vonë se 5 ditë-punë pas marrjes së vendimit përkatës.

4.2 Kopja e vendimit i transmetohet Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, i cili nëpërmjet drejtorisë së personelit bën regjistrimin në dosjet personale të punonjësve të policisë.

4.3 KPE-ja mund të ndërmarrë një procedurë rishqyrtimi për një vendim të dhënë vetëm në rast se ekziston një urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për të rishqyrtuar një vendim, i cili është marrë jo më parë se 25 ditë-punë. Në këtë rast, vendimi i KPE-së është përfundimtar.

5. Një program, trajnim, certifikatë (dëshmi apo diplomë) policore e dhënë jashtë shtetit, bëhet objekt shqyrtimi në KPE për qëllim ekuivalentimi, kur në DTP është regjistruar paraprakisht njëra prej të mëposhtmeve:

a) Marrëveshja dypalëshe e Ministrit të Brendshëm apo Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë me shtetin apo institucionin që ofron trajnimin;

b) Kërkesa e një prej departamenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë;

c) Kërkesa individuale e një punonjësi policie.

6. Shqyrtimi për qëllim ekuivalentimi bëhet duke iu referuar dokumenteve të mëposhtme, të cilat duhet të jenë regjistruar paraprakisht:

a) Marrëveshja ose kërkesa, me anë të së cilës kërkon ekuivalentimin;

b) Curriculum Vitae (kur ka një kërkesë individuale);

c) Kopja e programit, kurrikulës dhe certifikatës (dëshmisë ose diplomës) në gjuhën shqip dhe anglisht. Programi dhe kurrikula të përfshijnë minimalisht:

i) Objektivat mësimorë;

ii) Numrin total të orëve mësimore;

d) Përshkrimi i aktivitetit të institucionit trajnues dhe të burimeve të financimit.

7. Me njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit.

8. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani